



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 18-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27.09.2023, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 10,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Sllavisa Trajkovic

Të tjerë prezent

1. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
2. Përfaqësues të OSBE-së,

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Vizitë në lokalitetet ku banojnë komuniteti jo shumicë, në Grackë dhe Rubovc

Kryesuesi i komitetit Skender Bikliqi, tha se po vazhdojmë me rendit të ditës, vizitë ne teren qysh e kemi parapar.

Pastaj anëtarët e komitetit se bashku me kryesuesit vazhduan vizitën ne teren duke vizituar se pari shkollën ku mësojnë komuniteti serb në Rubovc, ku ne hyrje te shkollës u takuan me personelin e shkollës. Kryesuesi i komitetit i njoftoi personelin e shkollës qe se bashku me komitetit i kane vizituar te gjitha komunitetet jo shumice ne Janjeve, Lipjan,

Magure, Medvec, tani kemi caktuar vizitën ne Ruobc, për tu njoftuar nga ana juaj me vështirësitë qe përballeni ju si komunitet.

Pastaj personeli i kësaj shkolle i sugjeroj qe se pari është dashtë me marr leje nga drejtori i shkollës, pasi qe ne jemi paralele e ndare e shkollës fillore Vëllezërit Aksiq ne Lipjan. Është dashtë qe te merret leje atje dhe jo me penguar procesin mësimor. Ne vazhduam bisedën ne oborrin e shkollës ku u morën disa informacione , ku numri i nxënësve është duke u zvogëluar.

Nga anëtarët e komunitetit u pyeten pse nuk keni shkuar ne shkollën e re e cila është ndërtuar. Përgjigjja e personelit ishte se përgjigjen mund ta merrni te drejtoria e shkollës.

Pastaj vizitën e vazhduam ne fshatin Grackë të Vjetër ku anëtarit i komitetit Zoran Cirkovic, na njoftoi me problemet te cilat po e preokupojnë këtë fshat, si uzurpimi i pronës publike, sjelljet e disa te miturve ne poligone sportive, dëmtimi i rrugës qe është dëmtuar qe disa vite e etj.

Lidhur me këto shqetësime u tha se është mire te njoftohen organet kompetente

Meqë çështje të tjera nuk pati vizita përfundoi në ora 11³⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi